

#mosthujsekamdite

MARRËVESHJET PËR TC KOSOVA E RE PËRMBAJNË NDIHMË SHTETËRORE

Republika e Kosovës, sipas Ligjit për Ndhmën Shtetërore (05/L-100), e përkufizon ndihmën shtetërore si:

“Çdo shpenzim aktual apo shpenzim i mundshëm, apo reduktim i të ardhurave të shtetit, e dhënë në çfarëdo forme nga ana e dhënësit ose që mund t’i atribuohen shtetit, e cila drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthortë shtrembëron ose rrezikon ta shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar përfitues të caktuar të ndihmës shtetërore ose prodhime të mallrave dhe shërbimeve të caktuara, dhe që bie ndesh me obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës.”

100% BLERJE E SIGURTË

NKEC (kompani publike) detyrohet të blejë 100% të kapacitetit prodhues të TC Kosova e Re i cili pritet të prodhojë afërsisht 3,370,000 MWh në vit **edhe nëse tregu nuk e kërkon.**



KONKURRENCA

Për shkak se TC Kosova e Re ka prioritet mbi TC Kosova B, **tregu i energjisë elektrike në Kosovë do të mbyllet për 20 vite** duke bllokuar zhvillimin e çfarëdo konkurrence me shansa minimale për liberalizim të tregut të energjisë.



QASJA E LIRË NË RRJETIN E GJENERIMIT

Të gjitha pagesat për shfrytëzim të sistemit do t’i ngarkohen **NKEC** dhe jo **ContourGlobal**. Prodhuesit tjerë të energjisë elektrike janë përgjegjës për t’i mbuluar këto pagesa dhe i bën ata më pak konkurrues.



THËNGJILL KUALITATIV

KEK obligohet që të sigurojë thëngjillin, duke ua lënë konkurrentëve të **CountourGlobal** thëngjillin më pak efikas për një çmim më të lartë.



€10 PËR 33 HEKTARË

Toka ku do të ndërtohet TC Kosova e Re është dhënë në shfrytëzim për vetëm **10 Euro.**

